



KOLEGJI UBT

PLANI I PUNËS 2024/2025
FAKULTETI GJUHË ANGLEZE

Korrik, 2025

Table of Contents

1. HYRJE.....3

2. QËLLIMI I PLANIT:3

3. MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE7

4. ZHVILLIMI I KËRKIMIT SHKENCOR & INOVACIONIT9

5. MJEDISI I PUNËS.....11

6. NDËRKOMBËTARIZIMI, PARTNERITETET DHE KOMUNITETI.....12

7. PËRFUNDIM14

1. HYRJE

Ky Plan Pune është hartuar për të orientuar dhe strukturuar veprimtarinë akademike, kërkimore dhe institucionale të Fakultetit të Gjuhës Angleze në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) gjatë vitit akademik 2024/2025. Plani pasqyron punën e realizuar dhe angazhimet e planifikuara në përputhje me misionin institucional të UBT-së, standardet e sigurimit të cilësisë dhe kërkesat e akreditimit në arsimin e lartë.

Në kuadër të këtij plani janë përfshirë aktivitetet kryesore që lidhen me pranimin dhe regjistrimin e studentëve, menaxhimin dhe mbështetjen e tyre akademike, përgatitjen profesionale të stafit akademik, organizimin e procesit mësimor, si dhe zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Po ashtu, plani adreson çështje që kanë të bëjnë me mjedisin e punës, sigurimin e cilësisë, shërbimet administrative, ndërkombëtarizimin, bashkëpunimin me industrinë dhe kontributin e Fakultetit në komunitet.

Plani i Punës është ndërtuar mbi parimin e përmirësimit të vazhdueshëm, duke u mbështetur në monitorimin e rregullt të aktiviteteve, përdorimin e indikatorëve të matshëm dhe sigurimin e burimeve të verifikimit për çdo proces të paraparë. Përmes këtij dokumenti synohet rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, forcimi i kapaciteteve akademike dhe kërkimore të stafit, si dhe krijimi i një përvoje akademike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për studentët.

Ky plan shërben njëkohësisht si dokument udhëzues për strukturat drejtuese të Fakultetit dhe si bazë referuese për vlerësim të brendshëm, auditim dhe procese akreditimi, duke reflektuar angazhimin institucional për transparencë, cilësi dhe zhvillim të qëndrueshëm akademik.

2. QËLLIMI I PLANIT:

Qëllimi i këtij Plani Pune është të sigurojë një kornizë të strukturuar dhe koherente për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive akademike, kërkimore dhe administrative të Fakultetit të Gjuhës Angleze në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) gjatë vitit akademik 2024/2025.

Plani synon të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, të forcojë kapacitetet profesionale dhe kërkimore të stafit akademik, si dhe të përmirësojë përvojën akademike dhe mbështetjen institucionale për studentët. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë,

përmirësimin të mjedisit të punës, rritjes së ndërkombëtarizimit dhe forcimit të bashkëpunimit me industrinë dhe komunitetin.

Përmes përcaktimit të objektivave të qarta, aktiviteteve të strukturuar, indikatorëve të matshëm dhe burimeve të verifikimit, ky plan shërben si mjet orientues për vendimmarrje, vlerësim të brendshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional. Njëkohësisht, ky plan përfaqëson angazhimin e Fakultetit për transparencë, llogaridhënie dhe përputhshmëri me standardet e akreditimit dhe politikat institucionale të UBT-së.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Perioda	Indikatorët	Burimi i verifikimit
2.1	Pranimi dhe regjistrimi i studentëve	Organizimi i procesit të pranimit dhe regjistrimit të studentëve në Fakultetin e Gjuhës Angleze, i bazuar në notën mesatare shumë të mirë, me theks të veçantë në Gjuhë Angleze. Procesi realizohet përmes aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit përkatës, me regjistrim fizik në Prishtinë.	Koordinatori / Zyra e Studentëve / Fakulteti	Qershor Shtator 2024	Numri i studentëve të regjistruar dhe dosjet e kompletuara	Sistemi akademik, dosjet e studentëve, lista e regjistrimeve
2.2	Monitorimi i numrit të studentëve dhe vijueshmërisë	Monitorimi i numrit të studentëve të regjistruar dhe vijueshmërisë së tyre në Fakultetin e Gjuhës Angleze për vitet akademike 2021/2022, 2022/2023, 2023/2024 dhe 2024/2025. Analiza realizohet në baza semestrale për të identifikuar trendet e regjistrimit, vijueshmërisë dhe nevojat për ndërhyrje akademike ose administrative.	Koordinatori / Dekani	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i studentëve të regjistruar dhe raportet e vijueshmërisë	Sistemi akademik, raporte semestrale, evidenca e Zyrës së Studentëve
2.3	Zhvillimi profesional i stafit akademik	Nxitja dhe përkrahja e stafit akademik për pjesëmarrje në trajnime profesionale, akademi verore, konferenca	Dekani / Zyra e Cilësisë / Fakulteti	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i trajnimeve, konferencave dhe	Certifikata pjesëmarrjeje, raporte të trajnimeve,

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		shkencore dhe aktivitete kërkimore, me qëllim përditësimin e metodologjisë së mësimdhënies, avancimin akademik dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuale institucionale.			pjesëmarrjeve të stafit	programe konferencash
2.4	Përgatitja për fillimin e vitit të ri akademik	Koordinimi me stafin akademik përpara fillimit të vitit të ri akademik, përfshirë shpërndarjen e syllabuseve dhe literaturës, verifikimin e përputhshmërisë së syllabuseve me literaturën dhe objektivat e programit, si dhe konfirmimin e listave të studentëve nga ana e mësimdhënësve. Procesi siguron gatishmëri akademike dhe organizative për fillimin e suksesshëm të vitit akademik.	Dekani / Zyra e Cilësisë / Fakulteti	Para fillimit të vitit akademik 2024/2025	Syllabuse të verifikuara dhe lista të konfirmuara	Raport i Zyrës së Cilësisë, syllabuse të miratuara, evidenca e komunikimit me stafin
2.5	Menaxhimi dhe mbështetja e studentëve	Menaxhimi i regjistrimeve të studentëve në Fakultetin e Gjuhës Angleze sipas vendimeve të akreditimit, monitorimi i progresit akademik dhe identifikimi i studentëve që kanë nevojë për mbështetje shtesë. Procesi përfshin verifikimin e kredive, thirrjen në takime këshilluese dhe adresimin e faktorëve që ndikojnë në vijueshmëri dhe pjesëmarrje në provime.	Dekani / Zyra e Cilësisë / Zyra e Studentëve / Fakulteti	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i studentëve të regjistruar, takime këshilluese të realizuara	Sistemi akademik, procesverbale takimesh
2.6	Mbështetja e ekselencës studentore	Identifikimi i studentëve me notë mesatare mbi 9.00 dhe përfitimi i bursave institucionale për nivelin	Fakulteti / Zyra e Studentëve	Gjatë procesit të regjistrimit	Numri i bursave të ndara	Vendime për bursa, lista e përfituesve

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		Bachelor, si dhe dhënia e bursave në regjistrim për studentët që kanë dëshmuar sukses të lartë në arsimin e mesëm.		dhe vitit akademik		
2.7	Parandalimi i drop-out	Identifikimi dhe kontakti direkt me studentët me vijueshmëri të ulët ose progres të dobët akademik, me qëllim rikthimin e tyre në procesin mësimor dhe parandalimin e drop-out. Deri më tani evidentohet një rast i vetëm drop-out për shkak të largimit jashtë vendit.	Fakulteti / Zyra e Cilësisë	Gjatë vitit akademik	Numri i rasteve të trajtuara dhe rikthimeve	Raporte semestrale, evidenca e këshillimit
2.8	Ofrimi i shërbimeve administrative dhe mbështetëse për studentët	Ofrimi i shërbimeve administrative për studentët në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Zyrën e Studentëve, duke përfshirë përpunimin e dokumentacionit, vërtetimeve dhe kërkesave të ndryshme studentore gjatë vitit akademik.	Zyra e Studentëve / Zyra e Karrierës / Fakulteti	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i kërkesave të trajtuara	Evidenca administrative, kërkesa të protokolluara
2.9	Mbështetja financiare e studentëve të dalluar	Identifikimi dhe mbështetja e studentëve me notë mesatare mbi 9.00 përmes bursave institucionale në nivelin Bachelor, si dhe dhënia e bursave në regjistrim për studentët që kanë dëshmuar sukses të lartë në arsimin e mesëm.	Fakulteti / Zyra e Studentëve	Gjatë procesit të regjistrimit dhe vitit akademik	Numri i bursave të ndara	Vendime për bursa, lista e përfituesve
2.10	Sigurimi i cilësisë në shërbimet studentore	Në bashkëpunim me Komisionin e Cilësisë, organizohen takime të rregullta me studentët dhe përfaqësuesit e tyre për të mbledhur feedback mbi shërbimet dhe procesin mësimor. Gjithashtu	Zyra e Cilësisë / Fakulteti	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i takimeve, përqindja e materialeve në Moodle	Raporte të cilësisë, Moodle reports, procesverbale takimesh

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		verifikohet vendosja e materialeve mësimore në Moodle dhe përputhshmëria e tyre me syllabusin. Pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në aktivitete kërkimore dhe shkencore monitorohet si pjesë e kulturës së cilësisë.				

3. MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në Fakultetin e Gjuhës Angleze zhvillohen mbi parimet e cilësisë akademike, qasjes student-qendrore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor. Procesi mësimor është i strukturuar në përputhje me syllabuset e miratuara, të cilat përcaktojnë qartë objektivat e të nxënit, përmbajtjen mësimore, metodat e vlerësimit dhe aktivitetet në klasë, duke garantuar transparencë dhe koherencë në realizimin e programeve studimore.

Mësimdhënia realizohet përmes kombinimit të ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike, diskutimeve interaktive, punës në grupe dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare, me qëllim nxitjen e angazhimit aktiv të studentëve dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore, akademike dhe profesionale. Vëmendje e veçantë i kushtohet pjesëmarrjes aktive në klasë, vijueshmërisë së studentëve dhe përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies që mbështesin të nxënit kritik dhe reflektiv.

Mësimnxënia monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes evidencës së pjesëmarrjes, konsultimeve akademike, vlerësimeve formuese dhe përmbledhëse, si dhe feedback-ut të studentëve. Në rast të identifikimit të vështirësive në progresin akademik, ndërmerren masa mbështetëse, si tutorime shtesë dhe këshillim akademik, me qëllim përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe reduktimin e rrezikut për mos-vijueshmëri.

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies mbështetet nga përdorimi i platformave digjitale dhe materialeve mësimore të vendosura në Moodle, duke siguruar qasje të barabartë në burime mësimore dhe përputhshmëri të plotë me syllabuset përkatëse. Ky proces monitorohet dhe vlerësohet rregullisht në kuadër të mekanizmave të sigurimit të cilësisë, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës akademike të studentëve dhe cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
3.1	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies	Monitorimi i pjesëmarrjes aktive të studentëve në ligjërata, ushtrime dhe konsultime, përfshirë analizën e vijueshmërisë dhe angazhimit në klasë. Në rast nevojë, planifikohen tutorime shtesë për lëndët me kalueshmëri më të ulët.	Fakulteti / Ligjëruesit / Koordinator	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Pjesëmarrja në ligjërata dhe konsultime	Lista pjesëmarrjeje, raporte semestrale
3.2	Strukturimi i qartë i vlerësimit dhe aktiviteteve në klasë	Përcaktimi në syllabus i pjesëmarrjes obligative, aktiviteteve në klasë dhe përqindjes së tyre në vlerësim, duke siguruar transparencë dhe qartësi për studentët.	Ligjëruesit / Asistentët	Çdo semestër	Syllabuse të përditësuara	Syllabuse të miratuara
3.3	Zbatim i rregullt i procesit mësimor	Verifikimi i listave të studentëve dhe pjesëmarrjes reale nga ana e mësimdhënësve, si dhe dokumentimi i procesit mësimor në përputhje me politikat institucionale.	Ligjëruesit / Fakulteti	Çdo semestër	Listat e konfirmuara të pjesëmarrjes	Lista fizike dhe evidenca elektronike
3.4	Pasurimi i përvojës mësimore	Organizimi i ligjëratave tematike, aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe vizitave studimore të ndërlydhura me lëndët përkatëse, me qëllim lidhjen e teorisë me praktikën.	Ligjëruesit / Fakulteti	Çdo semestër	Numri i aktiviteteve të realizuara	Raporte aktiviteteve, evidenca fakulteti
3.5	Orientimi dhe mbështetja e studentëve të rinj	Organizimi i aktiviteteve orientuese dhe informuese për studentët e rinj në fillim të vitit akademik, duke përfshirë prezantimin e lëndëve dhe pritshmërive akademike.	Fakulteti / Ligjëruesit	Fillimi i vitit akademik 2024/2025	Numri i aktiviteteve orientuese	Raporte orientimi, evidenca pjesëmarrjeje
3.6	Mbështetja e vazhdueshme e vijueshmërisë	Përcjellja e vazhdueshme e vijueshmërisë së studentëve dhe ndërhyrja në kohë për të adresuar mungesat dhe	Ligjëruesit / Fakulteti	Gjatë çdo semestri	Stabilitet i vijueshmërisë	Raporte semestrale

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		rrezikun për mos-pjesëmarrje aktive.				

4. ZHVILLIMI I KËRKIMIT SHKENCOR & INOVACIONIT

Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit përbën një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë akademike në Fakultetin e Gjuhës Angleze. Fakulteti synon të krijojë dhe të forcojë një kulturë kërkimore aktive, e cila mbështet zhvillimin profesional të stafit akademik, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kontributin në zhvillimin shkencor dhe shoqëror në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kërkimi shkencor inkurajohet dhe mbështetet përmes pjesëmarrjes së stafit akademik në projekte kërkimore, publikimeve në revista shkencore dhe prezantimeve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Fakulteti, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të UBT-së, ofron përkrahje institucionale për aplikime në projekte kërkimore dhe për përfshirjen e stafit në iniciativa ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare, duke rritur kështu dukshmërinë dhe ndikimin akademik të punës kërkimore.

Inovacioni akademik promovohet përmes përdorimit të qasjeve bashkëkohore në kërkim, integritit të rezultateve kërkimore në procesin mësimor dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet stafit dhe studentëve. Studentët përfshihen aktivisht në kërkim shkencor përmes akademive verore, temave të diplomës dhe punës së përbashkët me profesorët, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe mendimit kritik.

Procesi i kërkimit shkencor dhe inovacionit monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë verifikimin e citimeve, respektimin e standardeve etike dhe vlerësimin e rezultateve kërkimore. Përmes këtij procesi, Fakulteti synon të sigurojë që aktivitetet kërkimore të jenë të qëndrueshme, të verifikueshme dhe në përputhje me politikat institucionale dhe standardet e akreditimit

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
4.1	Rritja e produktivitetit kërkimor dhe inovacionit	Përkrahja e stafit akademik të Fakultetit të Gjuhës Angleze në zhvillimin e hulumtimeve shkencore përmes mentorimit, mbështetjes institucionale dhe nxitjes për publikime në revista shkencore dhe konferenca të akredituara.	Fakulteti / Zyra e Hulumtimeve Shkencore	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i publikimeve dhe punimeve shkencore	Linke publikimesh, certifikata, raporte kërkimore

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
4.2	Angazhimi në projekte kërkimore	Inkurajimi i stafit akademik për pjesëmarrje në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë aplikimet në projekte të financuara nga BE dhe institucione të tjera relevante.	Fakulteti / Zyra e Projekteve / Zyra Ndërkombëtare	Gjatë vitit akademik	Numri i projekteve të aplikuara dhe të fituara	Dosje projektesh, kontrata, raporte projekti
4.3	Përdorimi i rrjeteve dhe platformave akademike	Nxitja e stafit për regjistrim dhe aktivitet në platforma akademike dhe kërkimore si Google Scholar, ORCID dhe ResearchGate, me qëllim rritjen e dukshmërisë dhe ndikimit shkencor.	Fakulteti / Zyra e Burimeve Njerëzore	Gjatë vitit akademik	Numri i stafit aktiv në platforma	Profile akademike, evidenca regjistrimi
4.4	Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore	Pjesëmarrja aktive e stafit në Konferencën Vjetore të UBT-së dhe konferenca të tjera shkencore ndërkombëtare, si dhe ftesa e ligjëruesve ndërkombëtarë (keynote speakers) për forcimin e bashkëpunimit akademik.	Fakulteti / Zyra e Hulumtimeve Shkencore	Çdo konferencë vjetore	Numri i punimeve dhe i ligjëruesve të ftuar	Program konference, certifikata pjesëmarrjeje
4.5	Përfshirja e studentëve në kërkim shkencor	Përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore përmes akademive verore, temave të diplomës dhe bashkëpunimit me profesorët në projekte dhe punime shkencore.	Fakulteti / Profesorët	Gjatë vitit akademik	Numri i studentëve të përfshirë	Raporte mentorimi, tema diplome
4.6	Sigurimi i cilësisë në kërkim shkencor	Monitorimi i cilësisë së publikimeve shkencore, verifikimi i citimeve dhe respektimi i standardeve etike dhe akademike në hulumtim.	Zyra e Cilësisë / Fakulteti / Knowledge Center	Gjatë vitit akademik	Numri i citimeve dhe publikimeve të verifikuara	Raporte cilësie, databaza shkencore
4.7	Projekte dhe fonde kërkimore	Pjesëmarrja në projekte kërkimore të financuara nga Ministria e Arsimit dhe institucione të tjera	Fakulteti / Zyra e Projekteve	Çdo vit akademik	Numri i projekteve dhe fondeve të fituara	Vendime financimi, raporte projekti

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim sigurimin e fondeve për zhvillim shkencor.				

5. MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës në Fakultetin e Gjuhës Angleze karakterizohet nga organizim funksional, bashkëpunim profesional dhe respektim i politikave institucionale të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT). Fakulteti synon të krijojë dhe të ruajë një ambient pune mbështetës dhe motivues për stafin akademik dhe administrativ, i cili kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë akademike, efikasitetin organizativ dhe përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit.

Menaxhimi i mjedisit të punës realizohet përmes ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësi, përshkrimeve të përcaktuara të punës dhe koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet strukturave drejtuese, stafit akademik dhe administrativ. Ky organizim mundëson funksionimin e rregullt të proceseve akademike dhe administrative, si dhe krijon kushte të favorshme për bashkëpunim dhe komunikim efektiv brenda Fakultetit.

Sigurimi i cilësisë në mjedisin e punës mbështetet përmes mekanizmave të vlerësimit të brendshëm, përfshirë pyetësorët për stafin dhe studentët, auditimet e brendshme dhe monitorimin periodik të performancës. Këto mekanizma shërbejnë për identifikimin e nevojave për përmirësim dhe për ndërmarrjen e masave të duhura në funksion të rritjes së kënaqësisë dhe efektivitetit në punë.

Zhvillimi profesional i stafit është pjesë integrale e mjedisit të punës dhe përkrahet përmes trajnimeve të vazhdueshme, pjesëmarrjes në aktivitete akademike dhe kërkimore, si dhe përfshirjes në iniciativa ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare. Fakulteti inkurajon përdorimin e teknologjive mbështetëse dhe mjeteve digjitale në mësimdhënie dhe kërkim, duke kontribuar në modernizimin e praktikave akademike dhe në krijimin e një kulture pune dinamike dhe inovative.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
5.1	Krijimi dhe mirëmbajtja e një mjedisi pune funksional	Organizimi i mjedisit të punës përmes ndarjes së qartë të detyrave, përshkrimeve të punës dhe koordinimit efektiv ndërmjet stafit akademik dhe administrativ, në	Menaxhmenti i UBT-së / Fakulteti	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Funksionimi i rregullt i proceseve	Vendime menaxheriale, përshkrime pune

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		përputhje me politikat institucionale të UBT-së.				
5.2	Sigurimi i cilësisë në mjedisin e punës	Zbatimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë përmes pyetësorëve për stafin dhe studentët, auditimeve të brendshme dhe vlerësimeve periodike të performancës.	Zyra e Cilësisë / Fakulteti	Çdo semestër	Numri i pyetësorëve dhe auditimeve	Raporte cilësie, formularë vlerësimi
5.3	Angazhimi dhe përfshirja e stafit	Inkurajimi i përfshirjes së stafit akademik në aktivitete ndërdisiplinore dhe në fakultete të tjera brenda UBT-së, në përputhje me normën e punës dhe nevojat institucionale.	Fakulteti / UBT	Gjatë vitit akademik	Numri i angazhimeve	Evidenca angazhimi
5.4	Zhvillimi profesional i stafit	Organizimi i trajnimeve shtesë sipas nevojave të stafit, përfshirë trajnime të brendshme, ndërkombëtare dhe trajnime për përdorimin e softuerëve dhe teknologjive mbështetëse për mësimdhënie dhe kërkim.	Fakulteti / Zyra Ndërkombëtare / Përgjegjësit e Laboratorëve	Gjatë vitit akademik	Numri i trajnimeve dhe stafit të trajnuar	Certifikata trajnimi, raporte aktiviteteve

6. NDËRKOMBËTARIZIMI, PARTNERITETET DHE KOMUNITETI

Ndërkombëtarizimi, partneritetet dhe bashkëpunimi me komunitetin përbëjnë një dimension thelbësor të zhvillimit strategjik të Fakultetit të Gjuhës Angleze në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Fakulteti synon të forcojë pozicionimin e tij akademik përmes zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare, rritjes së mobilitetit akademik dhe ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me institucionet arsimore, industrinë dhe komunitetin më të gjerë.

Ndërkombëtarizimi realizohet përmes ruajtjes dhe zgjerimit të marrëveshjeve ekzistuese me universitete dhe fakultete partnere, si dhe përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja që krijojnë mundësi për mobilitet të stafit dhe studentëve, shkëmbim akademik dhe aplikime në projekte evropiane dhe ndërkombëtare. Këto bashkëpunime kontribuojnë në rritjen e cilësisë akademike, diversifikimin e përvojës mësimore dhe forcimin e kapaciteteve kërkimore të Fakultetit.

Partneritetet me industrinë dhe institucionet relevante zhvillohen përmes organizimit të vizitave studimore, praktikave profesionale dhe aktiviteteve që ndërlidhin teorinë akademike me praktikën profesionale. Këto aktivitete synojnë të përgatisin studentët për tregun e punës, të rrisin kompetencat e tyre praktike dhe të forcojnë lidhjen e Fakultetit me nevojat reale të shoqërisë dhe ekonomisë.

Bashkëpunimi me komunitetin dhe promovimi i Fakultetit realizohen përmes aktiviteteve kulturore, debateve akademike, prezencës në media dhe takimeve me institucione arsimore dhe kulturore. Përmes këtyre aktiviteteve, Fakulteti kontribuon në zhvillimin kulturor dhe arsimor të komunitetit, duke reflektuar rolin e tij si institucion i angazhuar shoqërisht dhe akademikisht.

Tabela më poshtë pasqyron angazhimin e Fakultetit për të ndërtuar një rrjet bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, i cili mbështet ndërkombëtarizimin, përmirëson përvojën akademike të studentëve dhe rrit ndikimin institucional të Fakultetit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
6.1	Forcimi i ndërkombëtarizimit dhe partneriteteve	Ruajtja dhe zgjerimi i marrëveshjeve ndërkombëtare ekzistuese, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me universitete dhe fakultete partnere, me fokus në bashkëpunime akademike dhe aplikime në projekte evropiane.	Zyra Ndërkombëtare / Fakulteti	Gjatë vitit akademik 2024/2025	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara	Marrëveshje (MoU), raporte bashkëpunimi
6.2	Mobiliteti i stafit dhe studentëve	Realizimi i mobiliteteve të stafit dhe studentëve në kuadër të projekteve aktive të UBT-së dhe programeve të mobilitetit ndërkombëtar.	Zyra Ndërkombëtare / Fakulteti	Gjatë vitit akademik	Numri i mobiliteteve të realizuara	Raporte mobiliteti, dokumentacion projektsh
6.3	Organizimi i shkollave dhe akademive verore	Organizimi dhe realizimi i shkollave dhe akademive verore ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e stafit vendor dhe	Fakulteti / Zyra Ndërkombëtare	Korrik 2024 / Gjatë vitit akademik	Numri i prezantimeve dhe pjesëmarrësve	Program akademie, raporte aktiviteteve

Nr.	Objektiva	Aktiviteti (me sqarim)	Përgjegjësia	Periudha	Indikatorët	Burimi i verifikimit
		ndërkombëtar, në përputhje me kalendarin akademik.				
6.4	Bashkëpunimi me industrinë	Zbatimi i bashkëpunimit me industrinë përmes vizitave studimore të detyrueshme në kuadër të lëndëve, praktikave profesionale dhe konkurseve për punësim për studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze.	Fakulteti / Bordi Industrial / Qendra e Karrierës	Gjatë vitit akademik	Numri i vizitave, praktikave dhe konkurseve	Raporte vizitash, marrëveshje praktike
6.5	Bashkëpunimi me komunitetin	Zhvillimi i bashkëpunimit me institucione arsimore dhe kulturore, përfshirë marrëveshjet ekzistuese dhe ato në proces, me qëllim kontributin akademik dhe kulturor në komunitet.	Fakulteti / UBT	Gjatë vitit akademik	Numri i marrëveshjeve dhe aktiviteteve	Marrëveshje, raporte aktiviteteve
6.6	Promovimi i Fakultetit	Promovimi i Fakultetit të Gjuhës Angleze përmes takimeve me shkolla dhe institucione, prezencës në media dhe organizimit të debateve akademike dhe kulturore.	Fakulteti / Zyra e Mediave / Qendra e Karrierës	Gjatë vitit akademik	Numri i aktiviteteve dhe publikimeve	Raporte mediatike, evidenca promovimi

7. PËRFUNDIM

Plani i Punës 2024/2025 i Fakultetit të Gjuhës Angleze në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) përfaqëson një dokument gjithëpërfshirës dhe të strukturuar që orienton zhvillimin akademik, kërkimor dhe institucional të Fakultetit gjatë vitit akademik përkatës. Përmes këtij plani janë përcaktuar qartë objektivat,

aktivitetet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e monitorimit, duke siguruar një qasje sistematike dhe të qëndrueshme ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

Zbatimi i këtij plani synon të forcojë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, të mbështesë zhvillimin profesional dhe kërkimor të stafit akademik, si dhe të përmirësojë përvojën akademike dhe mbështetjen institucionale për studentët. Në të njëjtën kohë, plani adreson rëndësinë e krijimit të një mjedisi pune funksional, zhvillimit të kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe zgjerimit të ndërkombëtarizimit, partneriteteve dhe bashkëpunimit me komunitetin dhe industrinë.

Përmes përdorimit të indikatorëve të matshëm dhe burimeve të verifikimit, ky Plan Pune shërben si bazë për monitorim të rregullt, vlerësim të brendshëm dhe auditim institucional, duke kontribuar në transparencë, llogaridhënie dhe vendimmarrje të informuar. Zbatimi dhe rishikimi periodik i aktiviteteve të parapara do të mundësojnë identifikimin e nevojave për përmirësim dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese në funksion të arritjes së objektivave strategjike të Fakultetit.

Në përfundim, Plani i Punës 2024/2025 dëshmon angazhimin e Fakultetit të Gjuhës Angleze për cilësi akademike, zhvillim të qëndrueshëm dhe përputhshmëri me standardet e akreditimit dhe politikat institucionale të UBT-së, duke e pozicionuar Fakultetin si një njësi akademike aktive, transparente dhe të orientuar drejt së ardhmes.